



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:187105

Datë: 27.09.2023

Numri i dokumentit: 04725111

PPP.nr.155/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit të përmbartimit KRM “Pastrimi” sh. a., nga Prishtina, ndaj debitorit të përmbartimit R . G . nga Fushë Kosova, lidhur me çështjen përmbartimore për pagesën e borxhit në shumën prej 154.2 euro, sipas detyrës zyrtare, jashtë seance, me datë 27.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.216/20, i datës 31.01.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat F . B . nga Prishtina, si dhe të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat F . B . nga Prishtina me datë 31.01.2020, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.216/2020, sipas propozimit të kreditorit KRM “Pastrimi” sh. a., nga Prishtina, ndaj debitorit R . G . nga Fushë Kosova, për pagesën e borxhit në shumë prej 154.2 euro, duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afaristë.

Kundër urdhrin të lartcekur të përmbartuesit privat ka paraqitur prapësim vajza e debitorit, F .N. , e cila përveç tjerash në propozim ka cekur se babai i saj tashmë është i ndjerë dhe i ka bashkëngjitur certifikatën e vdekjes me nr. serik V . . . , të datës 07.02.2020 në të cilën figuron si datë e vdekjes së debitorit R . G . data . . .

Gjykata, pasi që nga provat e paraqitura nga vajza e debitorit vërtetoi se debitori ka vdekur, erdhi në përfundim se urdhri për përmbartim është i palejueshëm, sepse është lëshuar ndaj një personi i cili nuk mund të paraqitet si palë në procedurë, pasi që në kohën kur është lëshuar urdhri përmbartimor, pra me datë 31.01.2020, debitori ka qenë i vdekur, sepse siç u vërtetua më lart debitori ka vdekur me datë . . .

Gjykata vendosi kështu duke u bazuar në nenin 2, parag. 1, pika 1.6 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) ku është paraparë se “Palë - kreditori apo debitori në procedurën përmbartimtare”, ndërsa me nenin 17 të LPP-së parashihet se “Në procedurën përmbartimtare përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimtare, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”. Po ashtu neni 73, parag. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimtare (LPK), ka paraparë se “Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik”, ndërsa neni 76 i LPK-së parasheh se “Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”.

Nga arsyet e lartcekura, gjykata vendosi që ta anulojë Urdhrin Përmbartimtar P.nr.216/20, të datës 31.01.2020, si të palejueshëm, pasi që procedura nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundojë ndaj një personi i cili është i vdekur.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, vendosi duke u bazuar në nenin 13 të LPP-së, ashtu që vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATATHEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.155/20, datë 27.09.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.